



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
GJIMNAZI “PERIKLI IKONOMI” FIER**

RAPORTI VJETOR I SHKOLLËS 2024-2025

Hartoi grupi i punës:

1. Natasha Mino, drejtore
2. Aurela Lala, mësuese
3. përfaqësues i këshillit të prindërve
4. përfaqësues i qeverisë së nxënësve

DREJTORI

Natasha Mino

Realizimi/mosrealizimi i objektivave të planit vjetor dhe shkaqet

Në përfundim të vitit mësimor 2024-2025 shqyrtohet rezultati i arritur për secilin objektiv të planit vjetor të gjimnazit:

Objektivi i parë: *“Në përfundim të vitit mësimor (qershor 2025) niveli i kalueshmërisë së shkollës të jetë 95% nga niveli prej 93,6% i vitit të kaluar (Në këtë tregues nuk llogariten rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore)”* nuk është realizuar. Kalueshmëria në përfundim të vitit mësimor 2024-2025 (statistikat e qershorit 2025) është e nivelit 87,93%, më e ulët se një vit më parë. Shkaqe kryesore konsiderohen puna e dobët e mësuesve në pak lëndë, ku vihet re edhe numri më i lartë i nxënësve mbetës, largimet e nxënësve nga orët e këtyre lëndëve dhe zhvendosja e vëmendjes për disa muaj drejt përgatitjes për aktivitete të tjera (si p.sh. testimi PISA 2025).

Objektivi i dytë: *“Në përfundim të sesionit të parë të Maturës Shtetërore përqindja e maturantëve kalues që arrijnë notën mesatare të kërkuar për degët prioritare (7.5) të rritet në 60% nga niveli prej 56% (74 maturantë nga 132) i një viti më parë”*, nuk është realizuar. Notën mesatare për të vijuar studimet në IAL, e kanë arritur 82 maturantë nga 137, që përbën 59,85% të tyre. Por, për të vijuar në degët prioritare, mesataren e përcaktuar me VKM e kanë arritur vetëm 50,5% e maturantëve, që është më e ulët se një vit më parë. Shkak kryesor është planifikimi jo i saktë i orientimit të nxënësve në lëndët e maturës, duke mos pasur parasysh mungesën e laboratorëve në lëndët e TIK dhe veçanërisht përgatitjen e pamjaftueshme të maturantëve për të përballuar situata të papritura në provim (që u shfaqën dukshëm në provimin e matematikës).

Në aspektin financiar institucioni ynë nuk ka grumbulluar kontribute nga nxënësit dhe prindërit. Nuk ka pasur donatorë të disponueshëm për të kontribuar financiarisht për shkollën gjatë vitit 2024-2025. Përrjashtim bën një ish-nxënës i shkollës, i cili ka dhuruar një fotokopjues dhe ka realizuar mbulimin me internet me valë të mjediseve të brendshme të shkollës.

Risi të suksesshme të institucionit tonë gjatë vitit shkollor ka qenë rezultati shumë pozitiv i mësuesve në kualifikimin 2024-2025 ku dy mësuese kaluan testin e kualifikimit profesional me rezultatin “Shumë mirë”, ndërsa gjashtë mësues u kualifikuan për shkallën e parë dhe të dytë me rezultatin “Shkëlqyeshëm” (5 mësues) dhe “Shumë mirë” (1 mësues).

Bashkëpunimet e suksesshme të institucionit me biznese, institucione dhe OJF

Nuk ka pasur bashkëpunime me biznese, institucione të tjera dhe OJF. Por, me ndihmën e institucioneve eprorë, gjatë përgatitjeve për testimin PISA 2025, është bërë i mundur funksionimi i laboratorit të informatikës, megjithëse kompjuterët në të janë shumë të vjetër dhe të papërshtatshëm për programet e reja.

Certifikata, çmime etj., të fituara nga nxënësit e shkollës sonë

Në aktivitetet sportive të organizuara nga Qendra Kulturore e Bashkisë Fier në bashkëpunim me ZVAP Fier gjatë vitit shkollor 2024-2025 pjesëmarrja e nxënësve të gjimnazit “Perikli Ikonomi” ka qenë e qëndrueshme, duke arritur të fitojnë: në krosin e vjeshtës 2024 dy vende të para për djem (klasa XI, nxënësi Andrei Vrushi dhe XII, nxënësi Enxhi Xhepexhi), një vend të dytë për vajza (klasa X, nxënësja Altea Hamitaj) dhe një vend të tretë për vajza (klasa X, nxënësja Anna Cinus); vendin e tretë për vajza në kampionatin e shahut për vajza (Era Londo) dhe vendin e katërt për djem (Erdi Dimo); vendin e parë në kampionatin e basketbollit për vajza; vendin e dytë në kampionatin e futbollit për djem; vendin e katërt në kampionatin e volejbollit për djem dhe vendin e tretë në kampionatin e volejbollit për vajza.

Në fazën e dytë të olimpiadave kombëtare 2024-2025, nxënësit tanë nuk arritën të jenë fitues të ndonjë prej 5 vendeve të para.

Propozime për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në IA, në nivel vendor dhe kombëtar.

Në nivel kombëtar, për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore dhe planifikimin e saktë të organikës për vitin shkollor, duhet të përcaktohet me saktësi data kur llogaritet numri i nxënësve me efekt hapjen e klasave, pas së cilës të fillojë procesi i lëvizjeve paralele të detyruara. Ndërsa në nivel vendor duhet të përcaktohen qartë zonat e mbulimit (1 shkollë 9-vjeçare në 1 gjimnaz), ose të lejohen të gjithë nxënësit e qytetit të regjistrohen në të dy gjimnazet.